



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.09.2018, ora 11:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Projektligji “Për eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Anastas Angjeli dhe Ervin Bushati.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit për eurobondin që do të emetohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet, taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen.

Për të prezantuar projektligjin ndodhet ministri i Financave dhe i Ekonomisë. Relator i komisionit është zoti Anastas Angjeli.

Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit nga ana e ministrit, pastaj me relatorin e komisionit, me pyetje e përgjigje dhe në fund me diskutime.

Ju kërkojmë ndjesë për kushtet, por pas vendimit të Kuvendit ishim të detyruar që ta bëjmë mbledhjen këtu.

Fjala për ministrin.

Arben Ahmetaj – Eurobondi është një instrument me afat maturimi më shumë se një vit, i cili do të emetohet në monedhë të huaj në tregun ndërkombëtar.

Eurobondi i parë historik është emetuar në vitin 2010, i cili doli me një interes rreth 9 % dhe më pas në tregtim, për shkak të përkeqësimit financiar dhe fiskal të Republikës së Shqipërisë në vitet 2011 – 2012 shkoi në nivelet 11 deri në 12%.

Në vitin 2015 kemi shënuar daljen e dytë të eurobondit me një madhësi prej 450 milionë euro, me afat maturimi 5 vjeçar dhe me normë interesi 5,75, i cili maturohet më 12 nëntor të vitit 2020.

Emetimi i eurobondit në tregjet ndërkombëtare në këtë vit, me madhësi maksimumi deri në 500 milionë euro, me afat maturimi 5 deri në 10 vjet, preferencialisht 7,5 vjet, arsyet do t'jua them më vonë, vlerësohet si mënyra optimale për të plotësuar nevojat për financim për dy vjetët që vijnë, pra po bëjmë një parashikim afatgjatë të nevojave dhe sigurisht një optimizim, që do ta themi më vonë, të menaxhimit aktiv të detyrimit të borxhit në periudha afatshkurtër dhe afatmesme, i cili do të shoqërohet me një blerje mbrapsht, që në gjuhën teknike e quajmë *buyback*, të një pjese të eurobondit ekzistues prej 450 milionë eurosh që maturohet më 12 nëntor të vitit 2020. Emetimi i këtij instrumenti është në përputhje të plotë me objektivat e strategjisë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik të hartuar nga Ministria e Financave.

Dalja e Republikës së Shqipërisë serish në tregjet ndërkombëtare të kapitalit pas tre vjetësh mungesë, është një sinjal mjaft pozitiv për sa u përket kredencialeve të vendit, të certifikuara nga të dyja agjencitë e certifikimit fiskal dhe financiar ekonomik, ESP dhe Moody's. Gjithashtu, emetimi me sukses i eurobondit do të ishte një garanci më shumë për sa i përket përmirësimit të strukturës së borxhit dhe uljes së kostos në portofolin e borxhit.

Në këtë eurobond synohet të futen disa elemente të reja, si zgjerim i formatit, pra me 144 A. Ka dy formate, njëri format shkon vetëm për tregun europian dhe formati tjetër shkon për tregun amerikan. Herën e parë dolëm vetëm me formatin e tregut eruropian, ndërsa këtë radhë do të dalim me të dyja formatet. Pra siç ua thashë, synojmë variantin e një eurobondi 7-vjeçar.

Arsyeja pse synojmë eurobondin 7-vjeçar është shumë e thjeshtë. Edhe nëse do të shkonim me një eurobon 5-vjeçar përsëri nuk do të ishte keq, duke parë të gjitha maturimet ndërkombëtare deri në vitin 2023 praktikisht ka *count out* në tregje. Kështu që për të lehtësuar veten deri në vitin 2025 ne shtymë afatin nga 5 në 7 vjet, në mënyrë që ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë në vitin 2025 të mos ketë vështirësi, por të futet në treg në momente shumë më të qeta se sa momenti kur maturohen gati 90% e borxheve sovraane të rajonit dhe të disa vendeve të tjera me natyrë ekonomike dhe me natyrë menaxhimi borxhi si Republika e Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë ne bëjmë *buyback*, blerje mbrapsht. Arsyeja blerjes mbrapsht është shumë thjeshtë dhe shkon në kursin e menaxhimit të borxhit publik në vitin 2020. Imagjinoni sikur të mos bëjmë *buyback* në vitin 2020, do të thotë se Republika e Shqipërisë i duhet të bëjë *rollover* në plotësim të nevojave të financimit, nevojë që do të shkojë në 750-800 milionë euro. Për këtë arsye e lehtësojmë procedurën e vitit 2020, duke përfutur nga kushtet shumë të mira fiskale dhe financiare të Republikës së Shqipërisë dhe të tregjeve ndërkombëtare, në mënyrë që në vitin 2020 jo vetëm të ulim koston, por të lehtësojmë *rollover*-in. Mos harroni se para viteve elektorale politika fillon dhe nxehet dhe kjo nuk i bën aspak mirë tregut, por edhe imazhit të vendit. Kjo përkthehet në kosto më të mëdha, në risqe më të mëdha, dhe, sigurisht, nuk u bën aspak mirë buxhetit të shtetit dhe qytetarëve.

Procedura *buyback* me ankand, që i referohet në gjuhën teknike blerje mbrapsht, është (*tender offer*), maturimi i parakohshëm. Praktikisht maturimi do të ishte në vitin 2020, ndërkohë që për arsye lehtësimi të *rollover*-it në vitin 2020 ne e kërkojmë mbrapsht në vitin 2018.

Buyback-u është një procedurë, e cila të lejon të tërheqësh para kohe (po e shpjegoj për ju, por edhe për ta që janë të interesuar përtej kësaj zyre), para maturimit një instrument

ekzistues (ndryshe blerje mbrapsht e një titulli), të cilin ne e kemi emetuar në vitin 2015. Blerja realizohet me shumat e marra nga emetimi i eurobondit të ri. Kjo procedurë është brenda kuadrit ligjor bazuar si te ligji i borxhit, edhe te marrëveshja me Bankën e Shqipërisë.

Buyback-u gjen një aplikim të rëndësishëm në praktikat ndërkombëtare të menaxhimit të borxhit publik. Kjo është një procedurë rutinë në të gjitha vendet që bëjnë menaxhim të borxhit sovran dhe jo vetëm, por në rastin konkret për Shqipërinë kjo do të ishte hera e parë në tregun ndërkombëtar. Brenda vendit e kemi bërë në muajt mars, prill, maj, dhe qershor të vitit 2016, pas eurobondit për të lehtësuar tregun e brendshëm dhe për të ulur interesat e borxhit të brendshëm, gjë që realisht ndodhi dhe u realizua me sukses.

Procedura e *buyback*-ut është përdorur në tregun e brendshëm të titujve qeveritarë në vitin 2015, pas daljes nga tregu ndërkombëtar. Një objektiv i rëndësishëm për zbatimin e *buyback*-ut është ulja e riskut të rifinancimit sidomos në vitin 2020, kur shuma shkon 700-750 apo 800 milion euro. Gjithashtu, në bazë të pritshmërive parapagesa në vitin 2018 për instrumentin që maturohet në vitin 2020 mundëson në potencë dhe një kursim për shkak të koston së interesave.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rreth një vit që është duke u angazhuar dhe duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për një emetim të suksesshëm të këtij instrumenti. Procesi i emetimit të eurobondit ka kaluar në disa etapa të rëndësishme, midis të cilave:

1. Është ndryshuar baza ligjore për të akomoduar daljen në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, duke filluar që nga viti 2015, me qëllim rritjen e fleksibilitetit të huamarrjes me instrumente financiare që shtetit shqiptar t'i lehtësohet aksesit në tregjet financiare ndërkombëtare, duke synuar në uljen e koston së huamarrjes shtetërore.

2. Rregullimin ligjor, ku nivelet e huamarrjes shtetërore të përcaktuara në ligjin e buxhetit, të zbatohen në mënyrë fleksibël për të garantuar nivele më të kënaqshme të kostove. Pra, kjo ka të bëjë me likuiditete TSA në llogarinë e qeverisë. Besoj se ju, si Komisioni i Ekonomisë, do të më kuptoni shumë mirë, por për publikun do ta shpjegoj më thjeshtë. Në momentet e kalimit të viteve nga viti 2016 në 2017-ën ose nga viti 2018 në 2019-ën kontabilizimi i borxhit, kuptohet dhe menaxhimi të gjitha detyrimeve, siç iu referova edhe arsyetimit të *buyback*-ut.

3. Janë përzgjedhur rregulluesit kryesorë, që në gjuhën teknike quhen *Joint Lead Managers*, të cilët do të drejtojnë procesin e emetimit të eurobondit. Këto banka janë “Citi Bank”, “Banca IMI” në Londër dhe “Societe Generale”, me eksperiencë në tregjet e kapitalit dhe transaksionet financiare. Këto banka do të menaxhojnë përmbushjen e të gjitha

detyrimeve procedurale dhe teknike të nevojshme për realizimin e emetimit të eurobondit dhe do të rrisin interesin e investorëve, që do të jenë blerësit e këtij instrumenti.

4. Është përzgjedhur këshilltari ligjor ndërkombëtar për Shqipërinë, *Dechert LLP*, konsulenti ligjor i vitit 2015, i cili ka një eksperiencë shumë të mirë në prezantimin ligjor të Republikës së Shqipërisë.

5. Janë organizuar një sërë takimesh me bankat dhe institucionet ndërkombëtare për të marrë informacion mbi mundësinë dhe kushtet e emetimit të një eurobondi në tregjet ndërkombëtare.

Në qershor bëra një tur te disa investorë që kanë blerë eurobondin e 2015-s dhe investorë të mundshëm. Në gjuhën teknike quhet *non deal roadshow*, pra thjesht për të prekur interesin. Interesi duket i madh. Shqipëria konsiderohet me risqe të ulëta, madje në takimin në Londër, investorë seriozë na referuan se megjithëse jemi b+ apo b-stabël, në vlerësimin e brendshëm të tyre korporativ për Republikën e Shqipërisë jemi *double b*, pra jemi 2 b, me një këndvështrim shumë të përmirësuar. Kjo është edhe arsyeja pse ne shihemi ndryshe nga vendet me të njëjtin nivel vlerësimi.

Duke marrë në konsideratë parashikimet e deritanishme të bankave ndërkombëtare që shfaqin interes për eurobondin shqiptar, për kohën më të mirë për realizimin e këtij transaksioni, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është duke punuar me shumë intensitet.

Ju falënderoj për gatishmërinë, për përgjegjshmërinë, për shpejtësinë, që i dhatë këtij ligji, i cili në vetvete është një ligj që krijon logjistikën e duhur ligjore dhe teknike për të dalë sa më shpejt dhe me fleksibilitet në tregun ndërkombëtar!

Sipas vlerësime të paraqitura nga bankat ndërkombëtare, Shqipëria në 2018-n ka mundësi të pozicionohet edhe më mirë se viti 2015. Ky vlerësim mbi një pozicionim të mundshëm më të favorshëm të Shqipërisë në tregun ndërkombëtar, bazohet në konsolidimin fiskal të realizuar në vitet e fundit, të materializuar në balancë primare pozitive, për të cilën të gjithë ne rreth kësaj tavoline luftojmë vazhdimisht, që do të thotë se vendi nuk krijon borxh të ri, por trajton borxhin e trashëguar. Në tregjet ndërkombëtare ulja e borxhit është kyç. Ulja e borxhit dhe balanca primare janë dy nga disa indikacionet më të rëndësishme, ku investorët i referohen vendit dhe risqeve të ulëta të vendit;

përsheptimi i vijueshëm për disa vite rresht i rritjes ekonomike, bazuar në përmirësimin e fondamenteve ekonomike dhe pritshmërive pozitive për perspektiven afatmesme dhe afatgjatë;

reformimin substancial, deri më tani, në menaxhimin e financave publike dhe pritshmërinë pozitive për ecurinë në vijim;

tërësinë e reformave në një sërë fushash të tjera të realizuara deri më tani dhe ato të planifikuara në vijim, si dhe progresi i kënaqshëm deri tani në kuadër të integritetit europian.

Mos harroni, të nderuar deputetë, se fakti që në fund të vitit 2018 jemi në një nivel borxhi publik prej 67,5% (6-mujori rreth 65%) është përmendur si një nga elementet e përgjegjshmërisë së kësaj force politike, të kësaj maxhorancës dhe të kësaj qeverie dhe ka përmirësuar, le të themi, imazhin financiar, fiskal dhe ekonomik të Shqipërisë në sytë e investitorëve.

Ju e dini po kaq mirë sa unë, që tregu nuk komandohet dot nga Republika e Shqipërisë. Përkundrazi, tregu është pasqyra ku reformat tona duken ashtu siç janë. Nëse i kemi bërë reformat me *diligjencë*, në thellësi dhe në rrugën e duhur, tregu reagon pozitivisht, nëse jo, tregu reagon negativisht. Në rastin konkret pritshmëritë janë pozitive.

Ka shumë detaje, por unë nuk do të sjell detaje të tjera të punës.

Më lejoni të them me modesti se e vlerësoj atë që komisioni dhe parlamenti bën. Përtej punës së përditshme, është momenti të falënderoj të gjithë ekipin e Ministrisë së Financave për punën *diligjente* me qindra e qindra orë, për të përgatitur këtë instrument të ri në treg, sepse është realisht i ri, përfshin *buyback*-un, një format ndryshe, si dhe një afat më të gjatë!

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Angjeli...

Anastas Angjeli –Të nderuar kolegë, pa dashur të përsëris atë që theksoi ministri, besoj se nga pikëpamja teknike, ligjore, kohore dhe të kushteve ekonomike dhe financiare të vendit, s’jemi duke bërë gjë tjetër veçse duke miratuar një ligj që i hap rrugën një procesi mbase të nevojshëm dhe të domosdoshëm, siç është emetimi i eurobondit dhe procesi *buyback* i blerjes së tij.

Doja të theksoja se fakti që ne dalim për herë të tretë në tregun ndërkombëtar dhe na jepet kjo mundësi, është një sinjal pozitiv i ekonomisë ndërkombëtare dhe i tregjeve ndërkombëtare për ekonominë shqiptare. Është një sinjal pozitiv edhe nga pikëpamja e besimit (se ky është një moment shumë i rëndësishëm) të tregjeve ndërkombëtare në ekonominë dhe në stabilitetin financiar të Shqipërisë, por edhe një thirrje që u bëhet direk ose indirekt investitorëve të huaj për ekonominë shqiptare.

Besoj se shpjegimet u dhanë, megjithatë mund të ketë nevojë për një shpjegim më të plotë me 2-3 fakte për anëtarët e komisionit dhe për qytetarët.

Së pari, i gjithë ky proces që bëhet, ndikon apo jo në rritjen e borxhit, qoftë për momentin, qoftë afatgjatë? Deri diku ministri e tha...

Arben Ahmetaj – Mund t’ju shpjegoj me detaje edhe se si do ta trajtojmë në...

Anastas Angjeli – ...Edhe trajtimin. Pse? Sepse do të ngjallë sensibilitet, qoftë edhe në...

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ngjall sensibilitet. Më vjen keq që ndërhyj, por ju e dini po kaq mirë sa unë që nuk ka lidhje me rritjen e ...

Erion Braçe – Zoti Ministër, ta mbaroj fjalën zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Unë po them të kundërtën, por ju me sa duket nuk e kuptuat.

Arben Ahmetaj – Më fal!

Anastas Angjeli – Të fala paç!

U duhet thënë njerëzve që nuk ka lidhje me këtë çështje.

Së dyti, edhe pse këtu nuk deklarohet interesi, duhet kuptuar që bëhet fjalë për një rimarrje borxhi në kushte më të mira sesa borxhi i mëparshëm. Të gjitha këto janë të domosdoshme që të sqarohen me një veprim si ky i sotmi.

Meqenëse në orën 12:00 kam një angazhim, po largohem duke deklaruar votën time pro dhe ju ftoj edhe juve ta votoni atë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje?

Arben Ahmetaj – Shumë shkurt do t’ju shpjegoj se kjo ka të bëjë me menaxhimin e likuiditeteve dhe jo me rritjen e borxhit. Po ta shikoni, në ligjin e buxhetit të vitit 2018, neni 21 ka parashikuar edhe momentin e eurobondit: “Në rast emetimi të eurobondit, do të lejohet kontabilizimi specifik në llogarinë e qeverisë dhe mënyra se si do të deklarohet në tabelën fiskale do të jetë me dy nivele”. Cila është arsyeja? Këto janë likuiditete që, praktikisht, në një moment do të bëjnë *buyback*, kurse në momentin tjetër do të financojnë shpenzimet e qeverisë. Që primari është pozitiv, do të thotë që borxhi ulet, nuk rritet. Prandaj e theksova primarin. Likuiditetet pseudo, e tepërta, në llogarinë e qeverisë janë në momentin midis datës 31 dhjetor dhe datës 1 janar, pra kur mbyllet kontabiliteti qeveritar, por ato janë të gjitha për të bërë blerje mbrapsht dhe për të financuar nevojat e operacioneve që ne kemi në vitet 2019 dhe 2020. Pra, nuk ka rritje të borxhit. Në momentin e tepricës së likuiditetit, do ta deklarojmë me dy nivele: borxhi normal dhe eurobondi, i cili është likuiditet “i tepërt” për atë moment të datës 31 dhjetor 2018 në kontabilitetin qeveritar.

Së dyti, është interesi. Ne po tentojmë të dalim në këtë kohë, në mënyrë që të kapim momentin e mirë të ekonomisë shqiptare dhe të tregut.

Erion Braçe – Zoti Ministër, sa janë nevojat për vitet 2019 dhe 2020?

Arben Ahmetaj – Në përgjithësi nevojat janë neto dhe bruto. Neto është financimi i deficitit, që këtë vit është 29,5 miliardë.

Erion Braçe – Në vitin 2019?

Arben Ahmetaj – Po flas për vitin 2018.

Emetimi total është 315 miliardë, kurse shitja është rreth 287 miliardë. Kam përshtypjen se jam 99,99% shumë i saktë edhe me shifrat e emetimit të bonove të thesarit. Ne nuk e kemi mbyllur akoma buxhetin e shtetit për vitin 2019, por duke qenë në të njëjtën trajektore dhe nuk do të prodhojmë borxh të ri, mendojmë që deficitin do të jetë midis -1,9% deri në 2%. Kjo do të thotë që nevojat e financimit neto do të jenë rreth 28-29 miliardë, por me një instrument të përmirësuar ku, për shkak të mbështetjeve buxhetore nga donatorë të ndryshëm, nevojat në treg mund të shkojnë shumë më pak se këtë vit, pra 16-19 miliardë. Në aspektin e gjerë ekonomik kjo tregon që ne do të lëmë shumë më shumë likuiditete për kreditimin e ekonomisë. Pra, për shkak të konsolidimit fiskal, qeveria tërhiqet dalëngadalë nga tregu i bonove të thesarit shëndetshëm, sepse duhet ta kemi të angazhuar tregun në vazhdimësi.

Në varësi të menaxhimit të borxhit dhe të trajektores konsoliduese, shifrat për vitin tjetër do të jenë në të njëjtat nivele që unë thashë për sivjet, diku 300-315 miliardë dhe diku rreth 285-290 miliardë. Siç e shikoni, dalëngadalë e tërheqim qeverinë duke ulur borxhin nga tregu. Këto janë nevojat financimit.

Në vitin 2020, përtej nevojave të operimit, do të kërkohet financim për *all over*-in e vitit 2015 dhe për nevojat e financimit normal që ka qeveria në tregun ndërkombëtar. Për këtë arsye, për të mos e lënë atë vit të ngarkuar me gati 800 milionë kërkesë, qeveria vendosi të bëjë këtë operacion të koordinuar me elementin *buy back*-ut që iu referova. Është e rëndësishme, besoj se duhet të theksohet, që qeveria po mendon afatgjatë që të mos e lërë Republikën e Shqipërisë në vitin 2023 të ekspozuar në tregjet ndërkombëtare, ku të gjithë janë atje prezentë, por me këtë instrument afatgjatë nga 5 vjet në 7 vjet e gjysmë i jep mundësi asaj të dalë në vitin 2025. Unë mund t'ju vë në dispozicion një grafik ku tregohet se si nevojat e financimit pas vitit 2023 për vende të rajonit dhe disa vende të tjera me profil ekonomik dhe me profil borxhi si ne, fillojnë dhe bien. Kjo do të thotë se do të jemi më të lehtësuar në treg dhe me më shumë vëmendje nga investitorët në treg. Ky është edhe thelbi i të gjithë operacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Nga sa kuptova unë e gjithë kjo shumë do të duhet për të mbuluar nevojat e deficitit dhe pastaj edhe të borxhit që maturohet në vitin 2020?

Arben Ahmetaj – Po. Ky është thelbi i *buy back*-ut, që të ulë ngarkesën e vitit 2020. Ne do të bëjmë *buy back* edhe në treg, por këtë do ta vendosim në bazë të ligjit “Për huamarrjen publike”, do ta vendosim menjëherë pasi të kemi mbyllur transaksionin e eurobondit. Unë do të ulem të ribëj logjikën e ankandeve në mënyrë që të tërheqim, të bëjmë edhe blerje të brendshme. Përveç *buy back* -ut që do të bëjmë në tregun ndërkombëtar, të bëjmë edhe një blerje të brendshme rreth 100 milionë, që ta lirojmë komplet tregun e brendshëm edhe ngarkesën buxhetore.

Meraku që iu referua zoti Angjeli, nuk ka pse të ketë sensibilitet, sepse gjërat janë transparente, sidomos në këtë rast, që kur të mbyllet TSA-ja, pra llogaria e qeverisë më 31 dhjetor, kontabiliteti të jetë shumë e qartë sesa janë në llogari likuiditete gjendje dhe sesa është borxhi publik. Ky i fundit do të shkojë 67,5 ndoshta edhe 0,1- 0,2 më i ulët, por kjo është llogaria jonë paraprake.

Erion Braçe – Cila do të jetë shuma që do të përfshihet në *buy back*?

Arben Ahmetaj - 200 milionë, e kemi në relacion.

Erion Braçe - Ne do të kërkojmë për të marrë?

Arben Ahmetaj- 500. Brenda 500-shes është edhe 200-shja.

Erion Braçe – Dakord. Ka pyetje të tjera?

Po, urdhëroni!

Ervin Bushati - Në çfarë interesash vërtitet edhe tek tregu? Është ky momenti i përshtatshëm? Çfarë na avancon kjo gjë?

Arben Ahmetaj - Pra, cilat janë prerogativat e tregut sot?

E para, jemi në një moment ku Banka Qendrore Europiane ende nuk është tërhequr nga politika e saj për të hedhur likuiditete në treg për të ndihmuar vende si Italia apo vende të tjera që kaluan krizën, por ka deklaruar se gradualisht po tërhiqet, nga 30 miliardë që kishte kaloi në 15 miliardë tani. Vitin tjetër rrezik kalon në zero, që do të thotë se niveli i likuiditeteve dhe i garancive bien.

E dyta, ne duam ta paraprijmë reagimin e *federal reserve* të Amerikës, pra autoritetit monetar të SHBA-së për rritje të mundshme të interesit në vazhdimësi.

E treta, ne e shikojmë momentin ende të pangacmuar rëndë nga Turqia, e cila e ka ngacmuar, pra i gjithë zhvlerësimi i lirës dhe turbulenca ekonomike në Turqi ka ngacmuar tregjet, por ende jo vende si Shqipëria, letrën me vlerë të Shqipërisë nuk e kanë ngacmuar. Argjentina bëri një marrëveshje, marrëdhënie të re me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Nuk e dimë se çfarë do të ndodhë me Brex-it. Një qytetar thotë: “Mirë, çfarë lidhje kanë këto me ne?”. Kanë lidhje me tregun dhe me perceptimin që investitorët përtej nesh fillojnë dhe

perceptojnë risqet për të gjithë Europën dhe për vende si puna jonë. Në Bankën Qendrore Europiane ka një mundësi tjetër për likuiditetet në treg. Nëse do të kemi edhe ndryshime në drejtimin e Bankës Qendrore, ne nuk mund t’ia lëmë Republikën e Shqipërisë po i referohem kështu, se del Republika e Shqipërisë në tregun kapital, nuk del qeveria, më falni që e them këtë, në mëshirë të fatit nëse Banka Qendrore bën politikë të shtrënguar *Federal Reserve* fillon dhe bën një rritje të interesave. Në përllogaritjet tona risqet me 0,5% interes, rritja është 25 milionë dollarë në buxhetin e shtetit në vit, 25 milionë dollarë goditja në vit. Këto bisedat tona dikujt jashtë i duken si larg, por me një lëvizje në treg, goditja është 25 milionë dollarë në vit në buxhetin e shtetit.

Erion Braçe - Ka pyetje?

Ervin Bushati - Dihet që vlerësimi ka të bëjë edhe me stabilitetin politik, sepse ne vlerësimet i kemi shumë të mira, për sa i përket stabilitetit financiar dhe përmirësimit të notave tona. A mund t’i bëjmë një thirrje, ndoshta edhe opozitës në këtë rast, që ai teatri falas, që duket, nuk është aq falas, sepse çdo moment shqetësimi dhe turbulence mund të ndikojë dhe do ta paguajnë qytetarët shqiptarë, nuk do ta paguajë qeveria.

Erion Braçe - Po e bën opozitën faktor ndërkombëtar tani?

Ervin Bushati – Duhet patjetër qetësia në tregje.

Arben Ahmetaj – Besoj se brenda opozitës në nivelin teknik ka njerëz që e kuptojnë. Le t’i thërrasin mendjes, t’i bëjnë thirrje edhe lidhshimit që nuk e ka idenë për këtë punë dhe ndoshta dëgjon. Ne do të bëjmë detyrën.

Erion Braçe - Zoti Ministër, unë e kuptoj që ky është një instrument i dobishëm dhe i domosdoshëm për të menaxhuar borxhin publik të Shqipërisë. Ju e thatë se do të synoni dhe relaksim të tregut të brendshëm. A keni një parashikim se kush do të zë hapësirën që zinte qeveria deri tani?

Arben Ahmetaj - Tregu privat.

Erion Braçe- Tregun privat në cilët sektorë?

Arben Ahmetaj - Tani, nëse unë do të isha i gatshëm për çdo sektor. Mund ta filloja me energjinë, mund të vazhdoja me transportin, me manifakturën, me bujqësinë. Pra. me cilën të doni ju. Mund të flasim për kredinë konsumatore, kredinë për shtëpi.

Le ta shpjegojmë pak më thjesht, duke përfutur nga pyetja juaj. Në qoftë se e gjithë masa e kredisë, të mos fillojmë tani të shpjegojmë me një, me dy a me tre, se s’ka vlerë këtu, por le të themi se nga e gjithë masa e kredisë që vihet në dispozicion nga sistemi bankar, përfutojnë të gjithë aktorët kredimarrës, dhe një aktore kredimarrëse është edhe Shqipëria. Në qoftë se janë njëqind lekë dhe qeveria merr dyzet lekë, lë për tregun privat gjashtëdhjetë lekë.

Erion Braçe – Jam shumë i qartë për këtë.

Arben Ahmetaj – Në qoftë se qeveria merr njëzet, lë për tregun privat tetëdhjetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – ...edhe të Bankës së Shqipërisë, gjatë kësaj jave, do të vijë orientim i parasë pikërisht nga sektori i ndërtimit në sektorë të tjerë, me fokus të posaçëm eksportet.

Këtë shqetësim kanë. Shumë mirë, qeveria po hedh një hap të rëndësishëm për relaksim të tregut të huamarrjes. Problemi është: a ka ndonjë orientim se ku do të shkojë kjo, apo do at lëmë të lirë? Sepse, është i lirë sot, dhe çdo gjë po shkon te ndërtimi. Tani, ata e kanë shqetësim. Edhe ne, besoj, e kemi shqetësim.

Arben Ahmetaj – Në fakt, qeveria i përdor instrumentet që ka, për të orientuar financimin, investimin dhe kredimarrjen konsektivisht. Paketa që kemi bërë për bujqësinë, për SHPB-të, apo subvencionin që japin për fermerët, apo rimbursimi... A dini se nuk ka vende në Europë, që të rimbursojnë 20 %. Vetëm 6 % apo 7 % të rimbursojnë. Ne rimbursojmë 20 %. Pra, të gjitha këto politika fiskale dhe mbështetëse u thonë tregut privat se ky është drejtimi i duhur. Duke ulur TVSH-në për turizmin, duke bërë paketa për agroturizmin dhe për turizmin me katër-pesë yje, ne i themi tregut privat se ky është prioriteti i qeverisë, këta janë sektorët që ne lehtësojmë. Duke e bërë me një euro për manufakturat apo me lehtësimet e tjera të mundshme procedurale e fiskale, ne i orientojnë në këtë drejtim. Duke ulur tatim-fitimin nga 15 % në 5 % për teknologjinë, ne i udhëzojmë në atë drejtim. Pra, këto janë instrumentet tona.

Erion Braçe – Me gjithë këta instrumente, prapë paratë po shkojnë te ndërtimi.

Arben Ahmetaj – Unë besoj se tregu ka...

Erion Braçe – Dhe te ndërtimi, brenda një rajoni.

Arben Ahmetaj – Dakord, dakord! Ky është një diskutim më vete, përtej eurobondit, por unë besoj se ne mund ta lëvrojmë këtë në një tryezë goxha më të gjatë, le të themi, që t'i dedikohet kësaj. Është një nga debatet që ia vlejnë të bëhen. Në këndvështrimin tim, besoj se instrumentet që ka në dorë, qeveria i ka përdorur shëndetshëmrisht, duke ofruar paketa lehtësuese për sektorët.

Kuptohet, autoriteti monetar, në rastin konkret Banka e Shqipërisë, mund të bëjë më shumë, në harmoni me politikat e qeverisë, për të përçarur në sektorët e duhur të ekonomisë: ndërtimi, manufaktura, energjia, bujqësia, turizmi, industria minerare, industria përpunuese. Por mendësia e sektorit privat ka gjenetiksht logjikën e vet për të tërhequr kredi.

Gjithsesi, unë jam gati të bëjmë një diskutim më të thellë, më të gjatë.

Erion Braçe – Të themi të drejtën sektori i ndërtimit është sektor i rregulluar. Pa leje nuk ndërton kush më.

Arben Ahmetaj – Do të sugjeroja...

Erion Braçe – Fare mirë mund të vihet ndonjë kontroll, që të mos prodhohen flluska pastaj.

Arben Ahmetaj – Duke marrë shkas nga kjo, unë do të sugjeroja që, së shpejti, të bënim një diskutim, madje një diskutim publik të komisionit. Nëse do ta strukturojmë në këtë mënyrë...

Erion Braçe – Komisioni këtu është, në sy të publikut është, por problemi është që të jete qeveria. Komisioni këtu është.

Arben Ahmetaj – Qeveria i ka bërë instrumentet e veta, por s'është ky diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam fjalën për komisionin me aktorë të tjerë, jo komisioni me veten.

Erion Braçe – Ka kush pyetje tjetër?

Atëherë kalojmë në votimin e projektligjit “Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (buyback) të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen”.

Paraprakisht, para se ta votojmë, të mos krijohet asnjë lloj konfuzioni e të tjera me radhë, formulimi i këtij projektligji është motamo si dhe në rastet e tjera. Që të mos krijohet ideja se po bëjmë përjashtime nga tatimet e taksat, po heqim dorë nga imuniteti e kështu me radhë, për herë të parë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Në lidhje me nenin 3, siç e dëgjuat edhe nga njoftimi që bëri kryetari i Kuvendit, është marrë miratimi i Presidentit, që ky ligj të hyjë në fuqi menjëherë.

Kështu që, do të vonojmë nenin 3: ky ligj hyn në fundi menjëherë dhe do të botohet në Fletoren Zyrtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu, votojmë edhe nenin 3.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim projektligjin për votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Për dijeninë tuaj, përtej mbledhjes, me këtë që bëtë, të hënën Shqipëria listohet menjëherë në bursë.

MBYLLET MBLEDHJA